



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/ 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Dt. 09.02.2021

Për: Operatori ekonomik "XPERT SYSTEMS" NIPT L51511023L

Adresa: Njësia Bashkiake nr. 10, rruga "Mihal Duri", nr. 3, kati i III, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr. 17 datë 29.07.2020 me objekt: **"Blerje vula datare, vula shërbimi dhe darë vulosje"** me fond limit 5.891.040 (Pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyzetë) Lekë pa t.v.sh., të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a., me procedurë "Kërkesë për propozim", me mjete elektronike e cila u zhvillua me datë 26.08.2020, Ora: 10:00. [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-67375-07-29-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje vula datare, vula shërbimi dhe darë vulosje";

Fondi Limit: 5.891.040 (Pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyzetë) Lekë pa t.v.sh.

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme;

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 26.08.2020, ora 10.00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 03.08.2020* [49]

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Luar Bros” sh.p.k. NIPT L72322004M, me vlerë të ofertës ekonomike 5.447.200 (pesë milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “XPERT SYSTEMS” NIPT L51511023L me vlerë të ofertës ekonomike 5.850.000 (pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik “Muca” sh.p.k., NIPT K01421002H i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokumentacion tjetër shoqërues.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “**Luar Bros**” sh.p.k. NIPT L72322004M.
2. Operatori ekonomik “**Muca**” sh.p.k., NIPT K01421002H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “**Luar Bros**” sh.p.k. NIPT L72322004M

1. Vula Datore nuk përmbush specifikat e shkrimit, pasi në specifikimet teknike kërkohet që data, muaji dhe viti të jenë me shifra, ndërkohë që në mostrën e paraqitur muaji rezulton me shkronja;

2. Vula “U Pagua” nuk përmbush specifikat e përmasave, pasi në specifikimet teknike kërkohet që përmasat e vulës të jenë 38x14 mm, ndërkohë që në mostrën e paraqitur përmasat e vulës janë 36x13 mm;

3. Vula “Tarifë e marrë” nuk përmbush specifikat e përmasave, pasi në specifikimet teknike kërkohet që përmasat e vulës të jenë 38x14 mm, ndërkohë që në mostrën e paraqitur përmasat e vulës janë 36x13 mm;

4. Vula “E Porositur” nuk përmbush specifikat e përmasave, pasi në specifikimet teknike kërkohet që përmasat e vulës të jenë 38x14 mm, ndërkohë që në mostrën e paraqitur përmasat e vulës janë 36x13 mm;

5. Mostra “Darë vulosje” nuk përmbush këto specifikime teknike:

- Pjesët e brëndshme, për të shmangur çdo lloj rrëshqitje të mundshme, nuk janë të zmeriluara;

- Gërmat tek pjesa e punsonit poshtë nuk janë të gdhëndura në sipërfaqe, madje sipërfaqja e vulës së darës është e thellë dhe gjatë provës së bërë me plumçe, pas shtypjes ajo mbeti në pjesën e brëndshme të darës;

- Peshja e darës është 610 gr, ndërkohë në specifikimet teknike kërkohet jo më shumë se 600gr;

2. Operatori ekonomik “**Muca**” sh.p.k., NIPT K01421002H i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokumentacion tjetër shoqërues.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori ekonomik “**XPERT SYSTEMS**” NIPT L51511023L, adresa Njësia Bashkiake nr. 10, rruga "Mihal Duri", nr. 3, kati i III, Tiranë, ka paraqitur ofertën ekonomike 5.850.000 (pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.09.2020.

Ankesa: Ka patur.

Pranë Autoritetit Kontraktor është paraqitur ankesa si më poshtë vijon:

Me datë 08.09.2020, është paraqitur ankesë nga Operatori Ekonomik “**Luar Bros**” sh.p.k. me nr. 1522/11 prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. 1522/13 prot, datë 14.09.2020.

Operatori ekonomik “**Luar Bros**” sh.p.k., është ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur e cila me Vendimin nr. 62/2021prot, datë 04.02.2021 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik duke lejuar në këtë mënyrë AK Posta Shqiptare sh.a të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Laert Duraj

NË MUNGESË DHE ME POROSI
DREJTOR I DEPARTAMENTIT
TË SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË
Elidjana Çelaj